



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE
SEKTORI I PERSONELIT

SHPALLJE PËR POZICIONE TË LIRA

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr 89/2022 “Për Policinë Bashkiake si edhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”, kreu III “Rregullat dhe Procedurat e detajuara të pranimit në Policinë Bashkiake”, ligji nr 7961, datë 12.07.1995” Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, date 23.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.175 prot 6276 , datë 11.05.2026, “ Për Shpalljen e Konkurrimit për pozicionet e lira”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Durrës njofton se në Drejtorinë e Policisë Bashkiake shpallen vende të lira pune si më poshtë:

POLICË PRANË DREJTORISË SË POLICISË BASHKIAKE, SEKTORI I QARKULLIMIT 3 (TRE) POZICIONE.

POLICË PRANË DREJTORISË SË POLICISË BASHKIAKE, SEKTORI I KONTROLLIT TË TERRITORIT, 3 (TRE) POZICIONE.

1. PËRSHKRIMI PËRSGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN SI MË SIPËR ËSHTË:

Policia Bashkiake ka këto kompetenca dhe detyra, në përputhje edhe me aktet e tjera rregullatore:

- a. siguron zbatimin e akteve të nxjerra nga kryetari i bashkisë dhe këshilli bashkiak;
 - b. parandalon, konstaton dhe shqyrton kundërvajtjet administrative përmes forcimit, inspektimit dhe monitorimit në zbatim të akteve të njësisë të vetëqeverisjes vendore brenda territorit të juridiksionit të saj.
- Në fushën e rendit dhe sigurisë në komunitet, Policia Bashkiake:
 - a) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;
 - b) kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;
 - c) vendos kufizimin e qarkullimit në rrugë jashtë qendrave të banuara për ditët e festave lokale në bashkëpunim me organet e Policisë Rrugore
 - d) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë brenda territorit të juridiksionit të saj;
 - e) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve në territorin e juridiksionit të bashkisë;

- f) verifikon zbatimin e ligjshmërisë dhe patrullimin periodik në bashkëpunim me Policinë e Shtetit përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse të ujërave të brendshme në thellësi të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të bashkisë;
- g) monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të çdo personi juridik apo fizik pranë stacioneve të plazhit në territorin e juridiksionit të bashkisë;
- h) merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;
- i) mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;
- j) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.

- Në fushën e bashkëjetesës shoqërore, Policia Bashkiake:

- a) mbikëqyr respektimin e normave etike detyruese të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;
- b) mbështet organet e inspektimit për zbatimin e legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;
- c) siguron ekzekutimin e sanksioneve për lidhjen dhe zgjidhjen e kontratës së qirasë së banesave sociale me qira dhe kufizimet mbi banesat me kosto të ulët, të vendosura nga entet menaxhuese.

- Në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Policia Bashkiake:

- a) bashkërendon punën me strukturat përkatëse kur konstaton veprimtari të paligjshme për mjedisin, natyrën, pyjet, biodiversitetin dhe florën e faunën e egër;
- b) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të kontrollit mbi gjuetinë kur pengohen në kryerjen e detyrës;
- c) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse të inspektimit që mbulojnë veprimtarinë e peshkimit;
- d) bashkëpunon me strukturat përgjegjëse për ushtrimin e kontrollit për mbrojtjen e liqeneve ndërkuftare, brigjeve të tyre, zonave ujëmbledhëse, si dhe veprimtaritë që ushtrohen në to;
- e) verifikon dhe kontrollon zbatimin e kërkesave mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për zhurmat.

- Në fushën e veprimtarisë ekonomike dhe tregtare, Policia Bashkiake:

- a) siguron zbatimin e akteve që përcaktojnë kryerjen e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregtare apo shërbimi, ambulante, në vende publike të përcaktuara paraprakisht nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- b) verifikon respektimin e normave ligjore në lidhje me përdorimin në tregje apo vende të autorizuar nga bashkia të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme dhe vendosjen e materialeve reklamuese të pijeve alkoolike, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar drejtuar të miturve; mbështet strukturat përgjegjëse të taksave dhe tarifave vendore në veprimtarinë e tyre.

- Në fushën e mbrojtjes së shëndetit, Policia Bashkiake siguron respektimin e normave ligjore në lidhje me ndalimin e pirjes së duhanit në mjetet e transportit publik, përfshirë taksitë dhe mjediset e përbashkëta, në banesat me bashkëpronësi të detyrueshme.
- Në fushën e ruajtjes së hapësirës publike, Policia Bashkiake:
 - a. siguron zbatimin e rregullave për përdorimin e hapësirës publike, për ndalimin e zënies së hapësirave publike, hedhjen e mbeturinave dhe mbrojtjen e monumenteve, ndërtesave, parqeve dhe lulishteve publike;
 - b. vëren dhe konstaton ndërtimet e kundërligjshme, njofton dhe mbështet menjëherë strukturën përgjegjëse ndërtimore e urbanistike të bashkisë për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore;
 - c. siguron zbatimin e rregullave dhe procedurave për organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik të varrimit dhe për administrimin e varrezave në territorin e juridiksionit të bashkisë;
 - d. garanton zbatimin e përcaktimeve ligjore mbi afishimin e materialeve propagandistike në vendet jashtë përcaktimeve të bëra, duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore

1. KRITERET LIGJORE PËR PRANIM NË POLICINË BASHKIAKE

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- d) të ketë përfunduar arsimin e mesëm, të lartë;
- e) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;
- f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- g) të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;
- h) të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.
- i) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- j) Vjetërsi në punë një vit , në administratën publike, Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura, Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, Shërbimin për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, në profesionet e lira ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to në sektorin privat;
- k) Të ketë figurë të pastër morale.

2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a. kërkesën;
- b. jetëshkrimin;
- c. fotokopjen e kartës së identitetit;
- d. fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të mesëm të lartë;
- e. 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm;
- f. raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore;

- g. certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- h. vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;
- i. vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi;
- j. dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës;
- k. vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike;
- l. vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- m. vërtetimin që të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës, për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;
- n. vërtetimin e besueshmërisë që lëshohet nga struktura vendore e Policisë së Shtetit, me kërkesën e bashkisë përkatëse, përpara pranimit në Policinë Bashkiake.

3. FUSHAT KRYESORE MBI TË CILAT DO TË BAZOHET KONKURRIMI

- Njohuritë mbi ligjin nr.139, date 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikën e Shqipërisë
- Njohuritë mbi ligjin nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”
- Njohuritë mbi ligjin nr 7961, datë 12.07.1995” Kodi I Punës I Republikës së Shqipërisë”, I ndryshuar
- Ligji, nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.452, datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullorës kuadër të Policisë Bashkiake.

4. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

1. Pranimi në Policinë Bashkiake bazohet në parimet e shanseve të barabarta, meritës, aftësive profesionale dhe mosdiskriminimit.
2. Pranimi kryhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur përmes një procesi përzgjedhës dhe testimi transparent e të drejte.
3. Procesi përzgjedhës bazohet në vlerësimin e kriterëve dhe aftësive profesionale të kandidatëve.

Fazat e konkurimit do të jenë përkatësisht:

- Testimi me shkrim
- Testimi i aftësive fizik
- Intervista

- **Testim me shkrim (60 pikë)**

Testimi me shkrim kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga shpallja e listës së kandidatëve, që plotësojnë kriteret ligjore për t’u pranuar në Policinë Bashkiake.

Kandidati nuk kualifikohet për vazhdimin e konkurimit nëse nuk merr 60% të pikëve të përcaktuara.

Kandidati që merr më shumë 60% të pikëve të përcaktuara të testimit do të do të njoftohen për të vazhduar procesin e Intervistes

- **Testimi i aftësive fizike (20 pikë)**

Kandidatët që kalojnë testimin me shkrim i nënshtrohen testimit të aftësive fizike, i cili teston aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

- **Intervista me gojë (20 pikë)**

Intervista konsiston në testimin e aftësive të aplikantit për të komunikuar qartë, për të shprehur ide dhe koncepte, si dhe për të analizuar e për të marrë vendime.

Në këtë fazë konkurrimi, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 20 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;

b) intervista, deri në 10 pikë.

Kandidati që merr më shumë se 60 pikë për të dyja fazat konsiderohet i suksesshëm .

- **Afati i ankimimit është 5 ditë nga data e shpalljes së rezultateve të testimit.**

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesit do të shpallen në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Durrës (www.durres.gov.al) dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës jo fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht për rezultatet në mënyrë elektronike (nëpërmjet adresës së e-mail). Kandidatët jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Njësisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Durrës.

**Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve duhet të bëhet brenda
datës:26.05.2026**

Aplikimi dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të cituara më sipër, do të bëhet me postë ose dorazi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore apo Zyrën e Protokollit në Bashkinë Durrës në adresën - Bashkia Durrës, Sheshi “Liria”, 2000 Durrës.